VENDIM
Nr.1580, datë 3.12.2008

PËR MIRATIMIN E DISENJOS PËRFUNDIMTARE TË DOKUMENTEVE TË IDENTITETIT: LETËRNJOFTIMIT ELEKTRONIK DHE PASAPORTËS ELEKTRONIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 "Për ratifikimin e kontratës koncesionare, për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disenjos përfundimtare të dokumenteve të identitetit: letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës elektronike, sipas aneksit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Çdo akt nënligjor, që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha